



Worcester Regional Transit Authority

PARATRANSIT

**Akti për Amerikanët me Paaftësi (ADA)
UDHËZUESI I UDHËTARËVE**

Përmbajtja e udhëzuesit të udhëtarëve

- 1) Transporti WRTA ADA Faqja 3
- 2) Si të keni qasje në shërbimin shtesë WRTA ADA Paratransit Faqja 10
- 3) Udhëtimet me vonesë, udhëtimet e humbura dhe anulimet Faqja 12
- 4) Tarifat Faqja 14
- 5) Politika ADA për mosparaqitje/ procesi i apelit për mosparaqitje ... Faqja 15
- 6) Artikujt me vete..... Faqja 17
- 7) Kërkesat për PCA-të Faqja 17
- 8) Bakshishet Faqja 18
- 9) Caktimi i udhëtimeve me një lloj të veçantë automjeti Faqja 18
- 10) Moti ekstrem me borë Faqja 18
- 11) Shërbimi gjatë festave..... Faqja 19
- 12) Refuzimi i shërbimit ADA për shkak të sjelljes Faqja 20
- 13) Politika e rripit të sigurimit Faqja 20
- 14) Informacion për vizitorët Faqja 20
- 15) Udhëzimet për karrocet e invalidit/mjetet lëvizëse Faqja 21
- 16) Sigurimi i karrocave të invalidit në automjetet WRTA Faqja 21
- 17) Lista telefonike e ofruesve të shërbimit WRTA Faqja 22

Çfarë është transporti ADA?

Programi i shërbimit ADA Paratransit:

- Funkzionon në përputhje me rregulloren e [Administratës Federale të Tranzitit \(FTA\)](#)
- Është shërbim udhëtimi i përbashkët
- Është shërbim nga origjina në destinacion për klientë të kualifikuar ADA
- Ofron shërbim i cili mund të krahasohet në kohë me autobusin e linjës së fiksuar të rregullt, duke përfshirë kohën e pritjes dhe transferimet
- Funkzionon në të njëjtat ditë të javës dhe orë të ditës në të njëjtat zona si dhe autobusi i linjës së fiksuar të rregullt WRTA
- Është për njerëzit të cilët nuk mund të përdorin autobusin e rregullt WRTA për disa ose të gjitha udhëtimet e tyre

Programi i shërbimit ADA Paratransit nuk është:

- Shërbim taksi personal dhe duhet të parashikoni se do të udhëtoni me udhëtarë të tjerë të cilët po shkojnë në të njëjtin drejtim të përgjithshëm si dhe ju
- Në dispozicion kudo dhe në çdo kohë

Çfarë është transporti shtesë Paratransit i Aktit për Amerikanët me Paaftësi (ADA)?

Transporti ADA është për njerëzit paaftësitë e të cilëve i parandalojnë ata që të përdorin autobusin e linjës së fiksuar të rregullt WRTA për disa ose të gjitha udhëtimet e tyre. WRTA-ja e vendos kualifikimin duke u bazuar në konsiderata funksionale dhe ndihmon duke vendosur se cilët individë mund të përfitojnë më së shumti nga shërbimi ADA paratransit dhe cilët individë mund të shërbehen më së miri nga autobusi i linjës së fiksuar të rregullt WRTA. Ju duhet të aplikoni për shërbimin shtesë ADA Paratransit dhe të kualifikoheni sipas udhëzimeve të [Aktit për Amerikanët me Paaftësi](#).

Zona e shërbimit ADA është në dispozicion brenda një zone $\frac{3}{4}$ milje rreth e rrotull çdonjëres prej linjave të fiksuara WRTA. Çfarë do të thotë kjo për ju? Parafytyroni një autobus të linjës së fiksuar të rregullt WRTA dhe imagjinoni një flluskë që shtrihet $\frac{3}{4}$ milje në të gjitha drejtimet rreth e rrotull atij autobusi në rrugë - brenda kësaj flluske është zona e shërbimit ADA. I tërë qyteti i Worcesterit bie brenda zonës së shërbimit ADA. Shërbimi ADA është në dispozicion kurdoherë që autobusi i linjës së fiksuar të rregullt WRTA është në rrugë, në përgjithësi nga e hëna deri të dielën, me orë shërbimi të cilat ndryshojnë sipas ditës së javës dhe linjës. Ju lutemi vizitoni faqen e internetit www.therta.com për të shikuar orarin e autobusit WRTA.

Nuk ju duhet që të jetoni në zonën e shërbimit ADA për të pasur qasje në shërbimet ADA paratransit që ofron WRTA-ja. Megjithatë, duhet t'ju marrin ose t'ju zbresin në një adresë që ndodhet brenda zonës së shërbimit ADA që të keni qasje në shërbim dhe të dyja anët e udhëtimit tuaj duhet të bien gjithashtu brenda zonës së shërbimit ADA që të konsiderohen si udhëtim ADA.

Shërbimi shtesë ADA Paratransit është “shtesë” e autobusit të rregullt që do të thotë se udhëtimi në shërbimin paratransit zakonisht do të zgjasë po aq kohë sa do të zgjaste udhëtimi i bërë në autobusin e rregullt WRTA, duke përfshirë kohën e pritjes dhe transferimin nga njëri autobus në tjetrin.

Në qoftë se po planifikoni të ndërroni adresë, ju lutemi [na kontaktoni ne](#) fillimisht për të parë nëse adresa juaj e re ndodhet brenda zonës së shërbimit ADA me qëllim që transporti juaj paratransit të vazhdojë pa asnjë ndërprerje.

Cila agjenci qeveritare ka përgjegjësinë të mbikëqyrë përputhshmërinë me aktin ADA?

Zyra e të Drejtave Civile të Administratës Federale të Tranzitit (FTA) është përgjegjëse për përputhshmërinë me të drejtat civile dhe për monitorim duke siguruar ofrimin e padiskriminuar të shërbimeve të tranzitit. Për më tepër informacion, ju lutemi vizitoni faqen e internetit [FTA](#).

Kategoritë e kualifikimit ADA

Kush kualifikohet për transport ADA?

Transporti [Akti për amerikanët me paaftësi \(ADA\)](#) është për njerëzit paaftësitë e të cilëve i parandalojnë ata që të përdorin autobusin me qasje të linjës së fiksuar të rregullt për disa ose të gjitha udhëtimet e tyre.

Ju lutemi referojuni tri kategorive të mëposhtme të kualifikimit:

Kategoria 1 e kualifikimit

Kategoria 1 e kualifikimit përfshin, midis të tjerash, personat me çrregullime mendore ose pamore të cilët, si rezultat, nuk mund ta “manovrojnë sistemin”. Kjo kategori kualifikimi përfshin njerëz të cilët nuk mund të ngjiten, udhëtojnë ose zbresin nga një automjet me qasje “pa ndihmën e një individi tjetër”.

Kategoria 2 e kualifikimit

(Nuk ka të bëjë me shërbimin WRTA – të gjitha automjetet kanë qasje)

Kategoria 2 e kualifikimit ka të bëjë me personat të cilët mund të përdorin transportin me qasje të linjës së fiksuar, por transporti me qasje nuk po përdoret në atë kohë dhe në atë linjë ku do të udhëtonin personat. Ky koncept bazohet në linjë dhe jo në sistem.

Kategoria 3 e kualifikimit

Kategoria 3 e kualifikimit ka lidhje me individë të cilët kanë një gjendje specifike të lidhur me një çrregullim që i parandalon ata të shkojnë ose të vijnë nga një ndalesë apo stacion. Ky ka qëllim të jetë një “përrjashtim shumë i vogël” ndaj rregullit të përgjithshëm se vështirësia gjatë udhëtimit për në ose nga vendet e hipjes ose zbritjes nuk është bazë për kualifikim.

Që të jetë bazë për kualifikim, gjendja **duhet ta parandalojë** individin për të udhëtuar për në vendin e hipjes ose nga vendi i zbritjes. Fjala “parandaloj” është shumë e rëndësishme. Për këdo, të shkosh te stacioni i autobusit dhe të presësh autobusin është më e vështirë dhe më pak e rehatshme sesa të presësh për një automjet në shtëpinë tënde. Kjo ka gjasa të jetë akoma më e vërtetë për një individ me paaftësi. Por për shumë persona me paaftësi, në shumë rrethana, shkuarja te stacioni i autobusit është e mundur. Në qoftë se një gjendje e lidhur me një çrregullim vetëm se e bën punën e qasjes së tranzitit më të vështirë nga ç’mund të jetë ndryshe, por nuk e parandalon udhëtimin, atëherë personi nuk kualifikohet.

Procesi i aplikimit të brendshëm WRTA ADA

Të gjithë personat që dëshirojnë të kualifikohen për WRTA ADA mund të kontaktojnë PTM Brokerage Services, Inc. (Shërbimet Ndërmjetëse PTM) (PBSI) në numrin 508.791.9782 alternativa 3 për të caktuar takim për procesin e aplikimit të brendshëm.

PBSTM-ja ndodhet në 60 Foster Street, Worcester, MA, dhe **ofrohet transport falas vajtje-ardhje për të gjithë individët brenda zonës së shërbimit WRTA ADA Paratransit** kur udhëtoni për në zyrën PBSTM për të filluar procesin e aplikimit të brendshëm.

Kur të arrini, do t'ju kërkohet që të plotësoni një aplikim. Pastaj do t'ju jepet mundësia që të uleni me stafin për t'ju shpjeguar shërbimin dhe për t'ju bërë pyetje një me një. Mirëpresim gjithmonë që të sillni dikë me vete për të plotësuar aplikimin në qoftë se kjo është më e lehtë për ju. Shoqëruesi juaj ka gjithashtu transport falas vajtje-ardhje për sa kohë që ai hip dhe zbret në të njëjtin vend si dhe ju.

Kur të vini në takimin tuaj, ju lutemi që të sillni me vete informacionin e mëposhtëm:

- **Informacioni i kontaktit:** Ju lutemi sillni emrin, adresën dhe numrin e telefonit të profesionistit të licensuar të kujdesit shëndetësor* (HCP) që e njeh më së miri paaftësinë tuaj.
- Në qoftë se po aplikoni për shërbim në bazë të paaftësisë kognitive, ju lutemi identifikoni HCP-në e licensuar që i njeh më së miri kufizimet e lidhura me paaftësinë tuaj kognitive. Për shembull, në qoftë se paaftësia juaj është emocionale, mund të identifikoni një psikolog, psikiatër ose punonjës social të licensuar që i njeh më së miri kufizimet e lidhura me paaftësinë tuaj emocionale.

**HCP-të përfshijnë fizioterapistët, terapistët profesionalë, psikiatërët, psikologët, instruktorët e lëvizshmërisë, të gjithë këta të licensuar dhe mjekë e profesionistë të tjerë të licensuar të rehabilitimit.*

- **Informacioni i kontaktit urgjent:** Ju lutemi sillni emrin dhe numrin e telefonit të dikujt të cilin WRTA-ja mund ta kontaktojë në rast urgjence.
- **Mjeti lëvizës:** Në qoftë se do të udhëtoni në shërbimin ADA paratransit me një mjet lëvizës, kur të jeni këtu, stafi do ta masë mjetin me ju brenda në të për t'ju siguruar që peshat e nxënë dhe/ose përmasat e mjetit nuk e tejkalojnë ngarkesën e projektuar të ashensorit të automjetit dhe për t'ju siguruar që automjetet mund ta mbajnë mjetin lëvizës. Vendimet e kualifikimit **nuk** bëhen duke u bazuar në aftësinë e WRTA-së për të

transportuar mjetet lëvizëse. Do të bëhen të gjitha përpjekjet për ta ngarkuar mjetin tuaj lëvizës por WRTA-ja mund ta refuzojë transportimin e mjetit lëvizës/personit në qoftë se pesha e përbashkët ose dimensionet e mjetit lëvizës i tejkalojnë specifikimet e automjetit.

Procesi i verifikimit profesional WRTA ADA

Pas plotësimit të aplikimit ADA dhe pas dhënies së emrit, adresës dhe numrit të telefonit të profesionistit të licensuar të kujdesit shëndetësor (HCP) që njeh më së miri paaftësinë tuaj, PBSTM-ja do t'i dërgojë me postë një formular të veçantë HCP-së së licensuar të identifikuar prej jush. Duke u përpjekur që ky proces të ecë përpara, është e rëndësishme që ju të kontaktoni HCP-në që shënuat në aplikim për ta njoftuar atë se keni aplikuar për shërbim ADA. Kërkojini atij/asaj që të plotësojë formularin dhe t'ia dërgojë zyrës PBSTM sa më shpejt që të jetë e mundur.

Formularët e ardhur nga HCP-ja me informacion jo të plotë nuk do të konsiderohen si të plotë derisa i gjithë informacioni të jetë marrë nga zyra jonë. Pas marrjes nga PBSTM-ja të një formulari verifikimi profesional krejtësisht të plotë do të merret një vendim për kualifikimin e transportit brenda 21 ditësh nga marrja e formularit. Në qoftë se nuk është marrë vendim brenda 21 ditësh nga marrja e formularit të plotësuar të verifikimit profesional, atëherë aplikanti kualifikohet pa kushte deri në kohën kur të merret vendimi.

Procesi i aprovimit të aplikimit WRTA ADA

Pas plotësimit të aplikimit ADA dhe pasi të jetë marrë formulari i plotësuar i verifikimit profesional nga profesionisti i kujdesit shëndetësor (HCP), koordinatori ADA do të shqyrtojë informacionin. Në atë kohë do të merret një vendim për kualifikimin e transportit. Në qoftë se nevojitet më tepër informacion për të marrë vendimin në lidhje me aftësinë ose paaftësinë tuaj për të përdorur autobusin e linjës së fiksuar në bazë të kategorive të rrepta të kualifikimit siç përvijohen nga [Administrata Federale e Tranzitit](#), koordinatori i ADA-së do të kontaktojë aplikantin dhe/ose HCP-në.

Kur merret një vendim për kualifikim transporti, një numër rrjedhojash janë të mundshme:

- Mund të gjendet se individët kualifikohen pa kushte për të gjitha udhëtimet e tyre.
- Individët mund të marrin kualifikim me kusht në bazë të një rrethane të përkohshme, të tillë si këmbë e thyer ose trajtime me kimoterapi.
- Individëve mund t'u refuzohet krejtësisht shërbimi.
- Individët mund të kualifikohen për shërbim me kusht kur kushte të tjera (të tilla si moti ose terreni) ndikojnë në aftësinë e tyre për të pasur qasje në autobusin e rregullt.

Pasi të vendoset se kualifikoheni, qoftë me kusht ose pa kusht, mund të prisni që të merrni një pako me postë me të gjithë informacionin përkatës duke përfshirë letrën e kualifikimit tuaj. Ju lutemi rishikojeni të gjithë informacionin me kujdes.

Do të merrni gjithashtu një kartë identifikimi me foto të cilën duhet t'ia tregoni shoferit çdo herë që hipni në automjetin WRTA dhe që i duhet treguar shoferit me kërkesën e tij në çdo kohë.

Vendimet e kualifikimit zakonisht kanë një datë skadimi prej pesë vjetësh, por ato mund të jenë gjithashtu për një periudhë më të shkurtër kohe në bazë të vendimit të kualifikimit. Klientët, të cilëve u është refuzuar shërbimi, do të marrin një letër dhe informacion se si ta apelojnë vendimin.

Procesi i apelit të kualifikimit WRTA ADA

Meqenëse kualifikimi ADA paratransit është vendosur si e drejtë civile, janë vënë në vend metoda që të sigurohet ndjekja e "procesit të rregullt ligjor". Rregullat federale deklarojnë se procesi i apelit administrativ ka si qëllim t'u japë mundësi aplikantëve, të cilëve u është mohuar kualifikimi ose të cilët janë konsideruar të kualifikuar me kusht, që çështja e tyre të dëgjohet nga një komision i pavarur nga autoriteti i tranzitit ose vendimmarrësi fillestar. Ofrohet transport falas për te seanca dëgjimore e apelit në qoftë se bëni kërkesë.

E drejta për apel është si më poshtë:

1. Aplikantët kanë 60 ditë nga data e letrës së vendimit të kualifikimit që t'i bëjnë apel me shkrim WRTA-së kundër vendimit.

2. Para seancës dëgjimore, statusi i kualifikimit të aplikantit mbetet i pandryshuar nga vendimi fillestar i WRTA-së.
3. Apelet do të dëgjojnë nga një komision i pavarur nga WRTA-ja.
4. Aplikantët do të kenë të drejtë të flasin personalisht në emër të tyre dhe/ose të kenë persona të tjerë si përfaqësues të tyre në procedurat e apelit.
5. Aplikantët do të kenë të drejtë për mbështetje të nevojshme, të tillë si përkthyes, në qoftë se e kërkojnë këtë në letrën e apelit.
6. Vendimi i dalë nga apeli do të jepet me shkrim brenda 30 ditësh dhe do të deklarojë arsyet e vendimit. Në qoftë se nuk merret vendim brenda 30 ditësh nga data e apelit, do të jepet kualifikim i plotë derisa të merret vendimi.
7. Aplikantët mund të riaplikojnë për shërbim në çdo kohë në qoftë se ka ndonjë ndryshim në lëvizshmërinë e tyre funksionale.

KËRKESAT PËR APEL DUHEN BËRË ME SHKRIM TE:

WRTA Administrator
Worcester Regional Transit Authority
60 Foster Street
Worcester, MA 01608

Procesi i ricertifikimit WRTA ADA

Sipas paragrafit 37.125 të Departamentit të Transportit të Shteteve të Bashkuara (USDOT), një organ mund të kërkojë ricertifikimin e kualifikimit të individëve të kualifikuar për ADA paratransit në intervale të arsyeshme.

Në shkurt 2003, WRTA-ja, me të dhëna nga Grupi Këshillimor i Planifikimit të Transportit (TPAG), një grup të moshuarish dhe individësh me paaftësi të cilët veprojnë si Komision Këshillimor për WRTA-në, filluan procesin e ricertifikimit. Çdo individ të kualifikuar do t'i jepet një kartë identifikimi me një datë skadimi maksimum prej pesë (5) vjetësh.

Si të keni qasje në shërbimin shtesë WRTA ADA Paratransit

Telefononi numrin 508.752.9283 ose 1.877.743.3852 për të caktuar udhëtimin tuaj. Të gjitha prenotimet e udhëtimit mund të bëhen deri 7 ditë para por jo më vonë se 4:30 pasdite një ditë para udhëtimit.

Keni në dispozicion alternativën e prenotimit në internet, ju lutemi vizitoni faqen e internetit WRTA Paratransit te www.wrtaparatransit.com ose telefononi numrin 508.752.9283 për më tepër informacion.

- 1) Kur të telefononi që të caktoni një udhëtim, thojini marrësit të telefonatës:
 - a. Se doni të caktoni një udhëtim ADA;
 - b. Emrin tuaj;
 - c. **Adresën e saktë** (numrin dhe emrin e rrugës) ku doni që t'ju marrin;
 - d. Në çfarë ore doni që të jeni në destinacionin tuaj (jepni hollësi specifike në qoftë se po shkoni në një takim);
 - e. **Adresën e saktë** (numrin dhe emrin e rrugës) ku doni të shkoni; dhe
 - f. Në qoftë se do të udhëtoni me një mjet lëvizës, asistent të kujdesit personal (PCA) ose shoqërues.

Duhet të caktoni gjithashtu udhëtimin e kthimit. Të gjitha udhëtimet duhet të caktohen për **jo më pak** se (1) një orë.

Për shkak të numrit të madh të telefonatave që vijnë në qendrën e telefonatave, stafi nuk ka përgjegjësi që të kërkojë për informacionin e adresës. *Ju* duhet të jeni i përgatitur me adresën e saktë, duke përfshirë numrin dhe emrin e adresës, për vendin e marrjes dhe zbritjes.

- 2) **Rregullorja e ADA-së e lejon caktimin e udhëtimit tuaj deri në një orë para ose një orë pas orës së udhëtimit që kërkon ju, pa ju bërë vonë për takimin.**
- 3) Mbrëmjen para ose mëngjesin e udhëtimit, do të merrni një telefonatë të automatizuar me një hapësirë kohe prej 20 minutash për t'ju marrë për udhëtimin tuaj të caktuar. Keni përgjegjësinë që të prisni në një vend ku mund ta shikoni mbërritjen e automjetit gjatë gjithë hapësirës së kohës prej 20 minutash. Pas mbërritjes, automjeti do të presë për **pesë (5) minuta** para se të largohet për marrjen tjetër të caktuar.

Në qoftë se nuk merrni një telefonatë mbrëmjen para ose mëngjesin e udhëtimit tuaj të caktuar, mund të telefononi për të marrë informacionin e marrjes tuaj ose për të anuluar udhëtimin.

- Në qoftë se telefononi para orës 8:00 paradite ose pas orës 4:30 pasdite, telefononi Zyrën e Dispeçerit CMTM në numrin 508.453.3423.
- Në qoftë se telefononi midis orës 8:00 paradite dhe 4:30 pasdite, telefononi Zyrën PBSI në numrin 508.752.9283.

4) Kur të hipni në automjet, ju lutemi verifikoni destinacionin tuaj me shoferin.

Në qoftë se kërkohet që të udhëtojë me ju një kujdestar i kujdesit personal (PCA), ky person konsiderohet ndihmës i lëvizshmërisë dhe udhëton falas.

Mund të merrni gjithmonë një shoqërues udhëtimi. Shoqërues shtesë lejohen në bazë të disponueshmërisë së vendeve. Shoqëruesit paguajnë të njëjtën tarifë sa edhe personi që po shoqërojnë. PCA-të dhe shoqëruesit duhet të kenë të njëjtën adresë të marrjes dhe zbritjes që ka udhëtari ADA.

Kafshët e shërbimit mirëpritën në të gjitha automjetet WRTA.

- 5) Si udhëtar ADA që ndjek rregullat e shërbimit, qasja juaj në shërbim nuk mund të kufizohet nga shembujt e refuzimit, udhëtimet jashtëzakonisht të gjata, marrjet me vonesë ose faktorë të tillë të tjerë.
- 6) Abuzimi i rregullave të shërbimit mund të çojë në humbjen e shërbimit.
- 7) Shërbimi ofrohet në automjete të pajisura me ashensor si dhe automjete të tipit sedan. **WRTA-ja vendos se cili automjet do të dërgohet për të marrë një udhëtar.**

Orari dhe ditët e shërbimit ADA **Paratransit në Worcester**

Ditët e javës 4:50 paradite- 10:15 pasdite
Të shtunave 5:50 paradite- 10:25 pasdite
Të dielave 8:30 paradite- 7:30 pasdite

Telefononi WRTA-në në numrin 508.752.9283 për ditët e shërbimit, orarin dhe vendet për shërbimin ADA paratransit jashtë Worcesterit dhe për shërbime të tjera paratransit.

Udhëtimet me vonesë

Ndonjëherë, udhëtarët mund të kenë marrje ose zbritje me vonesë për shkak të motit të keq, trafikut, ndërtimeve ose rrethanave të tjera të paparashikuara. Udhëtimi me vonesë do të thotë një udhëtim i përfunduar ku automjeti mbërrin më vonë se koha e marrjes prej 20 minutash dhe/ose kur automjeti mbërrin në destinacion më vonë se koha e kërkuar për zbritje. Në qoftë se ndodh kjo gjë, ju lutemi kontaktoni PBSTM-në në numrin 508.752.9283 për ta raportuar këtë gjë sa më shpejt që të keni mundësi. Kjo do t'i japë mundësi PBSTM-së që të sigurohet që udhëtarët po marrin shërbim të qëndrueshëm me cilësi. Në qoftë se nuk jemi në dijeni, nuk mund ta rregulojmë.

Udhëtimet e humbura

Udhëtimi i humbur është rasti kur një automjet nuk mbërrin kurrë ose mbërrin më vonë se koha e marrjes prej 20 minutash dhe klienti zgjedh të mos e bëjë udhëtimin.

Anulimet dhe mosparaqitja

Për të anuluar një udhëtim:

- * Në qoftë se telefononi para orës 8:00 paradite dhe pas orës 4:30 pasdite, ju lutemi telefononi Zyrën e Dispečerit të CMTM-së në numrin 508.453.3423 për të anuluar udhëtimin tuaj.
- * Në qoftë se telefononi midis orës 8:00 paradite dhe 4:30 pasdite, ju lutemi telefononi Zyrën PBSTM në numrin 508.752.9283 për të anuluar udhëtimin tuaj.

Anulimi me vonesë është anulim i bërë brenda 1 ore që nga koha e caktuar e marrjes. Udhëtarët duhet të telefonojnë të paktën 1 orë para orës së caktuar të udhëtimit ose përndryshe do të konsiderohen se “nuk u paraqitën”.

Mosparaqitja është rasti kur automjeti mbërrin në vendin e marrjes brenda kohës së marrjes dhe klienti nuk është aty ose e bën anulimin te dera.

Udhëtimet e humbura që ndodhin për arsye që janë jashtë kontrollit të individit dhe probleme të lidhura me shërbimin nuk konsiderohen “mosparaqitje”. Udhëtimi i humbur nuk është “mosparaqitje”.

Në qoftë se u bënë shkak arsye jashtë kontrollit tuaj që të mos e merrni udhëtimin ose mendoni se është bërë një gabim, duhet të kontaktoni me shkrim

PBSTM-në brenda 15 ditësh nga data e letrës që deklaron se ju "nuk u paraqitët".

Dërgoni korrespondencë me email te noshow@therta.com ose me postë te PBSTM, 60 Foster Street, Worcester, MA 01608 (Attn: No-Show Staff). Në qoftë se korrespondenca juaj nuk është marrë brenda 15 ditësh nga data e letrës, "mosparaqitja" do të qëndrojë.

Tarifat WRTA ADA Paratransit

Tarifat

Tarifat ADA janë si më poshtë, për çdo udhëtim vajtje:

- 2,75 dollarë në qytet
- 3,00 dollarë një qytet më tutje
- 3,25 dollarë dy qytete më tutje
- 3,50 dollarë tre ose më shumë qytete më tutje

Të gjithë udhëtarët ADA Paratransit duhet të kenë një llogari pagese me parapagesë. Tarifat për udhëtarët dhe shoqëruesit zbriten nga llogaria. Tarifa nuk mund t'i paguhet shoferit.

Kujdestarët e kujdesit personal (PCA-të) konsiderohen si ndihmë për lëvizshmërinë dhe udhëtojnë falas.

Mund të merrni gjithmonë një shoqërues udhëtimi dhe shoqëruesit shtesë lejohen në bazë të disponueshmërisë së vendeve. Shoqëruesit paguajnë të njëjtën tarifë sa edhe personi që po shoqërojnë. PCA-të dhe shoqëruesit duhet të kenë të njëjtën adresë të marrjes dhe zbritjes që ka udhëtari ADA.

Politika WRTA ADA për **“mosparaqitje”/ procesi i apelit për** **“mosparaqitje”**

POLITIKA ADA PËR "MOSPARAQITJE"

WRTA-ja ka vendosur procesin e mëposhtëm për udhëtarët paratransit:

Udhëtarët duhet të jenë gati gjatë gjithë periudhës së marrjes prej 20 minutash. Shoferi do të mbërrijë në çdo kohë gjatë periudhës së marrjes dhe do të presë vetëm pesë (5) minuta pas mbërritjes së automjetit para se të largohet për në pikën tjetër të marrjes. Një individ konsiderohet se “nuk është paraqitur” në qoftë se ai/ajo nuk është i disponueshëm për marrje sipas përshkrimit të mësipërm.

Pas çdo “mosparaqitje” udhëtarit do t’i dërgohet një letër duke e informuar atë për mosparaqitjen. Në qoftë se udhëtari grumbullon tre "mosparaqitje" ose “anulime me vonesë” ose demonstroi mosparaqitje/anulime me vonesë të barabarta me 20% a më shumë të udhëtimeve të caktuara ose (cilado qoftë më e lartë) brenda një periudhe prej tre muajsh që nga "mosparaqitja" e parë, udhëtari do të pezullohet nga përdorimi i shërbimit.

Periudhat e mëposhtme të pezullimit do të zbatohen për shkeljet e kësaj politike që ndodhin brenda të njëjtës periudhë rrjedhëse 12 mujore.

- Shkelja e parë do të çojë në pezullim nga shërbimi për 7 ditë
- Shkelja e dytë do të çojë në pezullim nga shërbimi për 14 ditë
- Shkelja e tretë ose shkelje në vazhdimësi do të çojnë në pezullim nga shërbimi për 30 ditë

Udhëtarët kanë të drejtën që ta apelojnë atë vendim dhe atyre u jepen 15 ditë që t’ia dërgojnë WRTA-së apelin me shkrim. Një kopje e procesit të apelit për "mosparaqitje" i bashkëngjitet çdo letre.

PROCESI I APELIT PËR "MOSPARAQITJE"

Procesi i apelit administrativ të WRTA-së për "mosparaqitje" ka si qëllim që t’u japë mundësi udhëtarëve paratransit, të cilëve u është mohuar shërbimi, që çështjet e tyre të dëgjohen nga një zyrtar tjetër ndryshe nga ai që mori vendimin fillestar. Ofrohet transport falas për te seanca dëgjimore e apelit në qoftë se e kërkon atë.

Procesi i apelit për "mosparaqitje" është si më poshtë:

- 1) Udhëtarët të cilët dëshirojnë të apelojnë një vendim do të kenë 15 ditë kohë nga marrja e letrës së tretë për "mosparaqitje" që të bëjnë apel me shkrim te WRTA-ja.
- 2) Apelet do të dëgjohen dhe vendosen brenda 30 ditësh nga marrja e kërkesës. Ndërsa apeli është në proces e sipër, udhëtarët do të vazhdojnë të marrin shërbim paratransit për të cilin ishin kualifikuar para pezullimit të shërbimit. Në qoftë se apeli zgjat më shumë se 30 ditë, udhëtarët do të mund të marrin shërbim transporti derisa të jepet një vendim përfundimtar.
- 3) Apelet do të dëgjohen nga një komision i pavarur nga WRTA-ja.
- 4) Individët që apelojnë kanë të drejtë të flasin personalisht në emrin e vet dhe/ose të kenë persona të tjerë si përfaqësues të tyre (me shpenzimet e udhëtarit) në procedurat e apelit.
- 5) Individët që apelojnë kanë të drejtë për rregullime të nevojshme, të tillë si përkthyes të gjuhës me shenja.
- 6) Vendimi i dalë nga apeli do të jepet me shkrim dhe do të deklarojë arsyet e vendimit.
- 7) Në qoftë se keni ndonjë pyetje për procesin e apelit, kontaktoni cmellis@cmrpc.org ose telefononi numrin 508.459.3328.

KËRKESAT PËR APEL DUHEN BËRË ME SHKRIM DREJTUAR:

WRTA Administrator
Worcester Regional Transit Authority
60 Foster Street
Worcester, MA 01608

Politika WRTA për artikujt me vete në automjetet Paratransit

WRTA-ja i kufizon artikujt/pakot me vete deri në "atë sasi sa mund të mbajë udhëtari dhe/ose PCA-ja/shoqëruesi në një udhëtim pa ndihmën e shoferit dhe pa zënë më shumë se një vend".

Mosndjekja e kësaj politike mund të çojë në humbjen e shërbimit tuaj.

Kërkesat e WRTA-së për asistentët e kujdesit personal (PCA-të)

Asistentët e kujdesit personal janë individë asistencë e të cilëve nevojitet nga udhëtari për të udhëtuar. Kushdo që përfshihet në "procesin e ndihmës" që nevojitet nga udhëtari për të udhëtuar, ose gjatë udhëtimit në shërbim ose pas mbërritjes në destinacion, konsiderohet PCA.

Disa udhëtarë mund të kenë nevojë për PCA në të gjitha udhëtimet ose mund të kenë nevojë për të vetëm në disa udhëtime. Ju lutemi na informoni gjatë procesit të prenotimit nëse do të udhëtoni me një PCA.

Udhëtari ka të drejtë të përdorë PCA të ndryshme në vend të të njëjtit person gjatë gjithë kohës. Individët që kanë nevojë për PCA nuk lejohen që të veprojnë në të njëjtin kapacitet për të tjerët, sepse do të duhej të merreshin dy PCA për një udhëtim të një udhëtari.

Politika WRTA për bakshishet

WRTA-ja nuk lejon asnjë punonjës të përfshirë në ofrimin e shërbimeve të transportit WRTA që të pranojnë bakshish.

Politika WRTA për caktimin e udhëtimeve me një lloj të veçantë automjeti

Udhëtarët nuk mund të kërkojnë një lloj të veçantë automjeti kur kërkojnë shërbime ADA. WRTA-ja do të ofrojë shërbime në çfarëdolloj automjeti që ka në dispozicion në kohën dhe vendin e kërkesës së udhëtimit nga udhëtari.

Lajmërim për udhëtarët në lidhje me motin ekstrem dhe/ose me borë

Ndonjëherë është e nevojshme që ta heqim nga rruga shërbimin ADA Paratransit për shkak të stuhive të borës ose kushteve të tjera të motit ekstrem. Do të bëhet çdo përpjekje për ta mbajtur shërbimin në rrugë për sa kohë që dhënia e automjeteve të jetë e sigurt. WRTA-ja do të bëjë çdo përpjekje që të shmangë lënien e një individi në mes të rrugës gjatë motit të keq. Gjatë motit të keq, ju lutemi mendoni për rëndësinë e udhëtimit tuaj, si dhe keqësimin e mundshëm të kushteve të motit para se të largoheni nga shtëpia.

Në qoftë se shërbimi ADA Paratransit është hequr nga rruga, udhëtarët kanë përgjegjësinë që të organizojnë transportin e vet alternativ për udhëtime kritike (të tilla si trajtimet mjekësore ose punë).

Lajmërim për udhëtarët në lidhje me festat

I lajmërojmë udhëtarët se shërbimi ADA nuk funksionon gjatë të gjitha festave. Shërbimi ADA gjatë festave është i njëjtë me shërbimin e autobusit të linjës së fiksuar WRTA gjatë festave. Në qoftë se autobusët WRTA nuk janë në funksionim gjatë një feste, as shërbimi ADA nuk do të jetë në funksionim.

Për shembull, siç tregohet në tabelën e mëposhtme, në Ditën e Presidentit, udhëtarët e kualifikuar ADA mund të udhëtojnë vetëm duke përdorur shërbimin ADA kur funksionon normalisht shërbimi i autobusit të të shtunave. [Ofruesi i shërbimit tuaj lokal WRTA paratransit](#) mund t'ju japë informacion me hollësi për orarin e shërbimit ADA gjatë ditëve të javës, të shtunave dhe të dielave.

Niveli i shërbimit ADA në dispozicion gjatë çdo feste korrespondon me të njëjtin nivel shërbimi të autobusit të linjës së fiksuar WRTA në dispozicion gjatë çdo feste.

- * Dita e Martin Luther King, Jr.* - shërbimi i të shtunës
- * Dita e Presidentit* - shërbimi i të shtunës
- * Dita e Patriotëve* - shërbimi i të shtunës
- * Dita e Kolombit* - shërbimi i të shtunës
- * Dita e Veteranëve - shërbimi i ditëve të javës
- * Dita pas Ditës së Falënderimeve - shërbimi i të shtunës

** Linjat WRTA 29, 33 dhe 42 dhe autobusët e komunitetit funksionojnë sipas orarit të ditëve të javës gjatë këtyre festave. Linjat 19 dhe 30 funksionojnë me një orar të modifikuar të së shtunës gjatë këtyre festave.*

Ju lutemi kini parasysh: Nuk ka në dispozicion shërbim autobusi të linjës së fiksuar WRTA ose shërbim paratransit Ditën e Vitit të Ri, Ditën Përkujtimore, Ditën e Pavarësisë, Ditën e Punëtorëve, Ditën e Falënderimeve ose Ditën e Krishtlindjes.

Refuzimi i shërbimit ADA për shkak të sjelljes

Shërbimi ADA mund t'i refuzohet udhëtarit i cili angazhohet në "sjellje të dhunshme, seriozisht shkatërruese ose të paligjshme". Sjellja seriozisht shkatërruese nuk përfshin sjellje ose paraqitje që vetëm ofendon, acaron ose pengon punonjës ose udhëtarë të tjerë.

Në rastet kur udhëtarit i duhet refuzuar shërbimi ADA, **shërbimi duhet ndërprerë menjëherë**. Kjo duhet ndjekur nga një shpjegim me shkrim për refuzimin e shërbimit duke përfshirë procesin e apelimit të vendimit. **Dokumentimi i situatës që çoi në refuzimin e shërbimit ADA është jashtëzakonisht me rëndësi.**

Në raste të caktuara, administratori i WRTA-së ose i emëruari i tij/saj mund të mendojë se shërbimi mund të vazhdojë të ofrohet në mënyrë të sigurt në qoftë se përmbushen kushte të veçanta nga udhëtari. Por, në qoftë se nuk përmbushen kushtet, shërbimi për udhëtarin mund të ndërpritet menjëherë.

Politika WRTA për rripin e sigurimit

Sipas ligjeve të përgjithshme të Masaçusetsit, të gjithë shoferët dhe të gjithë pasagjerët ADA DUHET të vënë rripat e sigurimit përveçse kur paraqitet dokumentacion për një gjendje mjekësore që e ndalon përdorimin e tyre.

Informacion për vizita ose udhëtime

Alternativa të tjera për klientët WRTA ADA Paratransit

Si udhëtar i regjistruar i shërbimit WRTA ADA Paratransit kualifikoheni gjithashtu që të përdorni çdo shërbim tjetër mbarëkombëtar Paratransit të agjencisë së transportit. Rregullorja federale ADA ju lejon që të udhëtoni si vizitor në zona të tjera shërbimi Paratransit për 21 ditë brenda një periudhe prej 365 ditësh. Në qoftë se parashikoni që udhëtimi juaj t'i tejkalojë 21 ditë në një zonë të caktuar, mund t'ju duhet që të aplikoni për certifikim nëpërmjet asaj agjencie.

Për informacion shërbimi në lidhje me autoritete të tjera rajonale tranziti brenda Masaçusetsit, ju lutemi telefononi numrin 508.791.9782 ose vizitoni www.mass.gov dhe kaloni te "transportation" (transporti).

Udhëzime për karrocat e invalidit dhe mjete të tjera lëvizëse

Të gjitha automjetet WRTA kanë qasje, që do të thotë se ato kanë ashensorë lëvizës për individët me mjete lëvizëse dhe gjithashtu për individët të cilët nuk mund të përdorin shkallët për të hyrë në automjet. Paragrafi 37.165(b) i rregullores së Departamentit të Transportit të Shteteve të Bashkuara (USDOT) kërkon prej ofruesve të tranzitit që të transportojnë të gjithë individët përveçse kur e bëjnë një gjë të tillë nuk është në përputhje me kërkesat e ligjshme të sigurisë.

Në qoftë se po mendoni të blini një mjet lëvizës të ri, ju lutemi kontaktoni zyrën tonë në numrin 508.752.9283. Ne jemi të përkushtuar që t'ju ndihmojmë që të siguroheni që pajisjet tona të mund ta mbajnë me lehtësi mjetin tuaj lëvizës.

Politika WRTA për sigurimin e karrocave të invalidit në automjete

1. Karrocat e invalidit duhen siguruar vetëm në një pozicion me drejtim përpara.
2. Duhen përdorur të katër rripat për të siguruar karrocat e invalidit në shinat e dyshemesë.
3. Të gjithë pasagjerët duhet të vënë rripat e sigurimit përveçse kur kanë paraqitur informacion se një gjendje mjekësore e dokumentuar e ndalon përdorimin e tyre.
4. Udhëtarët në karroca invalidi të cilët e kanë të vështirë ta mbajnë pjesën e sipërme të trupit në pozicion drejt lart mund të përdorin një rrip për trungun e trupit kur ky sillet nga udhëtari.

WRTA-ja mendon se pasagjerët që përdorin mjete lëvizëse të tipit skuter me tri (3) ose katër (4) rrota shërbejnë më me siguri po të transferohen të ulur në sedilje.

Ofruesit e shërbimit WRTA Paratransit lokal

Për të mësuar më shumë për alternativat e tjera të transportit WRTA, ju lutemi telefononi qytetin specifik për të folur me një përfaqësues.

* Keni në dispozicion shërbimin e autobusit të linjës Flex (me devijim). Devijimet nga linja e fiksuar bëhen për publikun e përgjithshëm duke telefonuar numrin (508) 752-9283.

Obërn
508 752 9283
PBSI

Ist Brukfeld
800 321 0243
SCM Elderbus

Oukhem
800 321 0243
SCM Elderbus

Uejlls
800 321 0243
SCM Elderbus

Berlin
978 733 4747
Klinton COA

Graftën *
508 839 9242
Graftën COA

Oksford
508 752 9283
PBSI

Uorën
800 321 0243
SCM Elderbus

Bar
800 321 0243
SCM Elderbus

Holdën
508 210 5573
Holdën COA

Pekstën
800 321 0243
SCM Elderbus

Uebster
800 321 0243
SCM Elderbus

Bojlstën
508 752 9283
PBSI

Hollandë
800 321 0243
SCM Elderbus

Prinstën
800 321 0243
SCM Elderbus

Uestborou *
508 752 9283
PBSI

Brimfild
800 321 0243
SCM Elderbus

Lestër
508 752 9283
PBSI

Ratlend
800 321 0243
SCM Elderbus

Uest Bojlstën
508 752 9283
PBSI

Brukfeld
800 321 0243
SCM Elderbus

Millberi
508 865 9154
Millberi COA

Shrusberi
508 841 8640
Shrusberi COA

Uest Brukfeld
800 321 0243
SCM Elderbus

Çarlton
800 321 0243
SCM Elderbus

Nju Breintri
800 321 0243
SCM Elderbus

Sauthbrixh
800 321 0243
SCM Elderbus

Uorcester
508 752 9283
PBSI

Klinton
978 733 4747
Klinton COA

Northborou
508 752 9283
PBSI

Spencer
800 321 0243
SCM Elderbus

Dagllas
800 321 0243
SCM Elderbus

Northbrixh *
800 321 0243
SCM Elderbus

Stërbrixh
800 321 0243
SCM Elderbus

Dadli
800 321 0243
SCM Elderbus

North Brukfeld
800 321 0243
SCM Elderbus

Satën
800 321 0243
SCM Elderbus

